REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 5.3, nenin 52.2 shkronja a) të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 25.01.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 01.02.2011, miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË PUNËS TË KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN STATUTIT TË KOMUNËS SË GJILANIT, EDHE PËR HARTIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE, MIRËNJOHJEVE DHE SHPËRBLIMEVE TË TJERA

**I.** Me këtë vendim i vazhdohet afati i punës Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit i formuar sipas vendimit 01.nr.8359 të datës 09.07.2010, edhe për hartimin e Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera.

Anëtarët e emëruar të komisionit janë:

**1.** Hevzi Matoshi, kryesues,
**2.** Blerim Beshtica, anëtar,
**3.** Besnik Surdulli, anëtar,
**4.** Sadudin Berisha, anëtar,
**5.** Arben Mehmeti, anëtar,
**6.** Isa Shefkiu, anëtar,
7. Bardhyl Syla, anëtar,
8. Vaid Qerimi,anëtar,
9. Zhivojin Xhakliq,anëtar,
10. Renan Imami,anëtar,
11. Ibrahim Neziri,anëtar,

**II.** Komisioni do të bëjë hartimin e Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave,mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera për qytetarët nga komuna, vendi dhe jashtë vendit.
**III.** Komisionin, në cilësinë e zyrtarit do ta ndihmoj z.Sali Hasani, i cili do të mbaj procesverbalin, do të bëjë lektorimin dhe punët tjera teknike për mbarëvajtjen e punës së komisionit
**IV.** Për punët e vetë komisioni do t`i paraqes raport Kuvendit të Komunës.

**V**. Komisioni për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçantë.

**VI.** Vendimi është i plotfuqishëm ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01. Nr. 16-1324
Gjilan, më 01.02.2011

Kuvendi i Komunës.

_________________
Izmi Zeka, Kryesues